



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14 FEB 2024

14-352/01-24486/24, më

Në bazë të dispozitave të nenit 13, 17 shkronja g) dhe 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), Raportit të vlerësimit dhe evidentimit të gjendjes në terren nga aspekti i menaxhimit të mbeturinave i datës 08.11.2023 dhe dispozitave të nenit 52 dhe 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

Për shpalljen e gjendjes emergjente

1. Miratohet Vendimi për shpalljen e gjendjes emergjente për shkak të grumbullimit të mbeturinave në Kryeqytet të cilat mund të paraqesin rrezik për shpërndarje të epidemive, rrjedhimisht paraqesin rrezik për jetën e qytetarëve.
2. Sipas Raportit të Komisionit të vlerësimit dhe evidentimit të gjendjes në terren nga aspekti i menaxhimit të mbeturinave i datës 08.11.2023, janë evidentuar parregullsitë si:
 - Mungesa e inspektimit dhe shqiptimi i ulët i gjobave;
 - Hedhja e pavend e mbeturinave shtazore, ndërtimore, të vëllimshme etj;
 - Mungesa e lartë e makinerisë në ofrimin e shërbimit të kontraktuar;
 - Makineri jo adekuate për ofrimin e shërbimit (traktori, kamionetë pa mbulim, kamion të pa pastër, kamion që rrjedhin vajra etj);
 - Mungesë e lartë e kontejnerëve;
 - Vonesa në ofrimin e shërbimit në zonën ku ofrohet shërbimi derë më derë;
 - Mos respektimi i planit të mbledhjes së mbeturinave në zonën ku ofrohet shërbimi me kontejnerë publik.
3. Për adresimin dhe zgjidhjen e parregullsive të cekura si në pikën 2 të këtij Vendimi, mobilizohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori për menaxhimin e mbeturinave dhe ambientit, Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë si dhe Drejtoria e Inspektionit, ku masat të cilat do të merren janë si në vijim:
 - Rritja e numrit të kontejnerëve;

- Angazhimi i operatorëve tjerë potencial për të rritur numrin e makinerisë operative;
 - Larja e lokacioneve të kontejnerëve;
 - Rritja e inspektimit dhe numrit të gjobave nga Drejtoria e Inspektionit.
4. Pas ndërmarrjes së masave dhe veprimeve të cekura sipas pikës 3 të këtij Vendimi, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë, do t'i ndërmarrin të gjitha veprimet, duke krijuar edhe mekanizma shtesë të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë si dhe Drejtoria e Inspektionit dhe mekanizmat sipas vlerësimit të situatës.
 6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit. I njëjti mbetet në fuqi deri në një vendim marrje tjetër sipas vlerësimit të gjendjes nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe nga Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë.

Arsyetim

Ky vendim nxjerrët sipas raporteve të përgatitura nga Komisioni profesional i themeluar për vlerësimin dhe evidentimin e gjendjes në terren nga aspekti i menaxhimit të mbeturinave i datës 08.11.2023 dhe i udhëhequr nga Drejtoria e Shërbimeve Publike si dhe raporti i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë me nr. prot. 14-052/01-23455/24 i datës 13.02.2024, i cili ndër të tjera konstaton se " mbeturinat paraqesin rrezik për zhvillimin e ndonjë infeksioni apo epidemie, e sidomos tani që fillojnë të ngritën temperaturat, rreziku vetëm sa do të rritet duke dëmtuar shëndetin publik të qytetarëve".

Prandaj, për arsye të lartë cekura dhe duke u bazuar në nenin 17 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

U dorëzohet:

- Drejtorisë së Shërbimeve Publike;
- Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë;
- Drejtorisë së Inspektionit;
- Qendrës për Shërbim me Qytetarë;
- Në dosje.

